



Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh dhe stafi të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+, në Riga Technical University, Letoni

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për studentët dhe stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Riga Technical University – RTU.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime.
- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime.
- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe të kenë përfunduar vitin e parë akademik).
- **Master** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin Politeknik të Tiranës).

Kohëzgjatja e bursave për studentët: 1 semestër, (semestri i dytë, i vitit akademik 2023-2024)

Fushat e studimit për studentët: Të gjitha degët. (Studentë e interesuar të shohin lëndët që ofrohen nga RTU, sipas fakulteteve përkatëse, në linkun: [Faculties | Riga Technical University \(rtu.lv\)](https://www.rtu.lv/faculties)

Numri total i studentëve: 4 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve Bachelor deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Master:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve Master deri në momentin e aplikimit;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;



- Dokumenti Learning Agreement**.

Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar është **B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në RTU lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ te seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e ‘‘Learning Agreement’’ klikoni te:

[Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](#) , aneks 2.

Për t’u njohur me lëndët që ofrohen në RTU, sipas niveleve dhe fushave të studimit, klikoni në link-un: [Faculties | Riga Technical University \(rtu.lv\)](#)

Afati për aplikim për studentët: Deri më 10 tetor 2023, ora 12.00

Aplikimi për studentët kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Numri total i stafit akademik për mësimdhënie: 1

Kohëzgjatja e bursave për stafin: 5 + 2 ditë, gjatë semestrit të II të vitit akademik 2023 – 2024.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësive bazë dhe nga përgjegjësi i njësive kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t’u kryer në universitetin pritës;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës, për stafin akademik;
- Letër Motivimi, (Arsyeja e lëvizshmërisë dhe motivimi).
- Plani i propozuar i lëvizshmërisë (Sa më i detajuar - aq më mirë!)
- Të paktën një nivel B2 të gjuhës angleze
- Stafi që nuk ka marrë pjesë më parë në programin e shkëmbimit Erasmus+ do të ketë përparësi.
- Stafi që ka marrë një letër ftese nga departamenti i RTU-së do të kenë përparësi.



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
– Mobility for learners and staff –



Për të shkarkuar formatin e “Staff Mobility for Teaching, Mobility Agreement” klikoni te:
[Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](#) , aneks 4.

Për t’u njohur me programet e studimit në RTU, sipas fakulteteve, klikoni në link-un: [Faculties](#) | [Riga Technical University \(rtu.lv\)](#)

Procesi i përzgjedhjes për stafin:

Stafi i interesuar për mobilitet, duhet të dorëzojë, brenda datës 20 shtator 2023, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit, dokumentacionin e mësipërm.

Kandidaturat do t’i propozohen RUT – së, nga i cili do të bëhet përzgjedhja e 1 kandidature.

Stafi i nominuar do të plotësojë formularin e aplikimit online të RTU.

Linku i aplikimit: <https://incomingexchange.rtu.lv/courses/course/17-exchange-staff-exchange>

Pasi kandidati të dorëzojë aplikimin e tij, departamenti specifik në RTU ku kandidati po aplikon e shqyrton aplikacionin dhe ose e pranon ose e refuzon aplikacionin.

Koordinatori i RTU Erasmus+ njofton kandidatin dhe institucionin e origjinës (UPT) nëse aplikimi ka qenë i suksesshëm.

Afati për aplikim për stafin: Deri më 20 shtator 2023, ora 12.00

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail:
abeqo@upt.al , rkodra@upt.al